

Këngët tonë, vallet tonë,  
trashëgimia jonë  
kulturore është e njohur  
nëpër botë. Çfarë  
krenarie zgjohet tek ne  
kur dëgjojmë që dikush i  
këndon këngët tonë ose i  
luan vallet tonë, sepse  
folklori ynë është dëshmi  
për ekzistencën tonë  
shekulliore.

Pensionistët, banorët më të vjetër të vendit tonë, janë të vetë-dijshëm për këtë dhe prandaj me zemër dhe shpirt e ruajnë dhe kujdesen për folklorin tonë. Angazhimi i tyre ndaj ruajtjes të këtij amaneti është i njohur edhe nga shteti. Ministria e kulturës në vendin tonë tashmë nëntë vite, 8 revytë rajo-nale dhe republikane të këngës, muzikës dhe valleve i shpall si projekt me interes nacional dhe i mbështet financiarisht. Ashtu është edhe këtë vit me çka 260 mijë pensionistë janë shumë falenderues.

Në muajin prill dhe maj u mbajtën tetë revytë raxonale të këngës, muzikës dhe valleve niko-qirë të të cilave ishin shoqatat nga Shkupi: Qendra dhe shoqata e pensionistëve të luftës dhe shoqat e pensionistëve: Prilep, Tetovë, Vinicë, Sveti Nikole, Vallandovë dhe Vevçan. Në ditët kur u mbajtën këto manifestime të rëndësishme kulturore, festuan të gjitha gjeneratat, të rinjtë ishin krenarë me energjinë dhe dëshirën e madhe të qytetarëve më të vjetër që të tregojnë kush jemi dhe çka jemi. Revytë gjithkund ishin festë edhe për sytë edhe për shpirtin. Në salla kënduan të gjithë së bashkë, e kënduan këngën e bashkërisë dhe bashkëjetesës të cilat janë të domosdoshme për të gjithë ne.

Ashtu ishe edhe më 7 qershor 2019 në Shtëpinë e ARM-së në Shkup në sallën e stërmbosej. Mysafirëve dhe pensionistëve të

## BULETINI I PENSIONISTËVE PËR VITIN 2019

# FOLKLOR PËR JETËN NË RMV



pranishëm nga skena e zbukuruar me elemente folklorike e para iu drejtua kryetarja a LSHPM, Stanka Trajkova e cila së pari i përhëndeti mysafirët e rëndësishëm: Kryeministrin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev, i cili për herë të parë është mbështetës i këtij manifestimi kulturor masiv të pensionistëve në të cilin morën pjesë mbi 1000 pensionistë së bashku me revytë rionale, me çka i nderoi dhe respektoi banorët më të vjetër të vendit tonë, zëvendësministri i kulturës, Vlladimir Lazovski, mysafirët nga R. e Bullgarisë, Serbia dhe Mali i Zi, dhe

ministër i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev, të nderuar mysafirë nga vendi dhe jashtë vendit, për herë të parë kur u mbajt revyja republike e pensionistëve e këngës, muzikës dhe valleve, kryeministri i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev pranoi që të jetë me ne dhe përkrahës i këtij manifestimi masiv folklorik i pensionistëve, i cili me prezencën e tij i dha rëndësi edhe më të madhe këtij manifestimi”, tha ajo mes tjerash.

Pastaj t  pranishm ve me fjal  t  ngrohta iu drejtua kryeministri, Zoran Zaev dhe e hapi Revyn  e 9-t  Republikane t  keng ve, muzik s dhe valleve

"Te penderuar pensionistë të

A photograph of a church interior during a performance. Four men in white shirts and dark trousers sing into microphones. A fifth man on the right plays a ukulele. Above them, a traditional outfit (white shirt, red vest with embroidery, white pants, and patterned socks) hangs from the ceiling on a hanger.

nderuar mysafirë nga vendi dhe jashtë vendit, në fillim, më lejoni që ta shpreh kënaqësinë time që kam nderin të hap këtë manifestim të rëndësishëm - Revynë e nëntë republikane të pensionistëve të këngëve, muzikës dhe valleve 2019 në organizim të Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, ndërsa nën patronazhin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ju pensionistët, jeni qytetarët tanë më meritor, të cilët në mënyrë aktive merrni pjesë në ndërtimin e shtetit. Ju i vendosët themellet e shtëpisë sonë të përbashkët - vendit tonë. Për ato arsy, gjeneratat e tanishme jemi të obliguar t'ju shprehim respekt dhe falënderim të madh. Me shëndet të mirë dhe shumë vite tjera, ky manifestim të jetë moment i mirë dhe arsy që të takohemi dhe të shoqërohem. Nder i veçantë është përmua të jem mbështetës i manifestimeve të tillë republikane të cilat i organizoni”, u shpreh kryeministri Zaev.

Të dyja fjalimet ishin të shoqëruara me duartrokitje të fuqishme nga ana e të pranishmëve. Pastaj u rradhitën shfaqjet e 25 shoqtave të përzgjedhura anëtare të

Lidhjes. Tingujt e borive dhe daul leve, këngët dhe vallet e plotësuan sallën e mbushur të Shtëpisë së ARM-së. Në sallë nuk kishe vende të zbrazëta, ashtu siç nuk kishe prej atyre që ishin indiferentë. Këngët zgjonin kujtime të rinisë, zemrat e pensionsitëve të cilët val-lézonin rrihnin në ritmin e muzikës. Të gjithë donin ta luanin sa më mirë vallen nga rrethi i tyre dhe ta këndojnë këngën e përzgjedhur, duke i harruar vitet dhe problemet.

U ndërthurën ndjenjat e krenarisë së rrënjeve të tyre, krenarisë që bota na njeh pikërisht për bukurinë dhe origjinalitetin e folklorit, për këngët dhe vallet të cilat janë shenja shekullore të identitetit dhe palëkundshmërinë tonë.

Krenari, edhe pse jemi një vend i vogël, kemi pasuri kulturore me të cilën rrallë kush mund të lavdërohet nëpër botë. Historia e të gjithë atyre që jetojnë në vendin tonë është shkruar në këngët, në traditat e pasurisë sonë kulturore dhe është një nga shtyllat e shoqërisë sonë multikulturore. Në këto hapësira është realizuar bashkëjetesa, pa dallim feje, gjuhe dhe kombi. Respekti ndaj njëri tjetrit ka qenë udhërrëfyesi jonë në të kaluarën dhe shembull për gjeneratat që vijnë.

Në revy, të gjithë pjesëmarrësit, të gjitha interpretimet u shpër-blyen me duartrokitje të gjata. Revyja republikane, e nënta me radhë, për këngë, muzikë dhe valle vazhdoi me shoqërimin e përbashkët, në të cilën, pensionistët me prezencën e saj i nderoi ministria e punës dhe politikës sociale, Mila Carovska, ndërsa u ndanë mirënjojhe për pjesëmarrje në Revyën republikane të këngës, muzikës dhe valleve për shoqatat pjesëmarrëse në revy. (K.S.A)

SHP OHËR DHF DEBËRCË

# PENSIONISTËT NË “FESTIVALIN E MOKRO KOZAIK”

Në pajtim me Memorandumin për bashkëpunim me Sindikatën e Konfederatës së pensionistëve nga Pogradeci i Shqipërisë, më 24 maj 2019 delegacioni i udhëheqësisë së SHP Ohër dhe Debërcë i udhëhequr nga kryetari i Kuven- dit, d-r Dimitar Spaseski dhe krye- tari i Këshillit ekzekutiv, Gjorgji Trpçeski, mori pjesë në manifestimi- min e parë kulturor-turistik, me ti- tull "Festivali i Mokro Kozaik", në fshatin Dunicë, rrëth 25 kilometra larg Pogradecit, i vendosur në rajo- nin e Mokrës së Epërme dhe të Po- shme, në të cilën gravitojnë 17 fshatra. Në manifestimin kulturor morën pjesë rrëth 300 vizitorë nga fshatrat përreth të këtij rajoni ma- lior të Malit Mokra, ndërsa në pro-

gram interpretuan shumë grupe muzikore dhe solo interpretues, si dhe nxënës nga shkolla e fshatit Dunicë të gjitha nga Shqipëria.

stëve të Pogradecit. Me fjalë rasti, të pranishmit e manifestimit i përshëndeti edhe kryetari i SHP Ohër dhe Debrëcë, Gjorgji Trpçeski, i cili përzemërsisht u falënderua për ftesën, me çka e potencoi edhe bashkëpunimin e suksesshëm dhjetëvjeçar mes SHP Ohër dhe Debërcë me pensionistët e Pogradecit. Trpçeski, uroi që manifestimi të bëhet tradicional dhe më masiv, që në të të marrin pjesë ansamble folklorike nga vendet fqinje, dhe përmes tij të zgjerohet dhe përforcohet bashkëjetesa dhe bashkëpunimi në planin kulturor dhe sportiv, sepse vetëm ashtu të bashkuar do të mund të përparojmë dhe të arrijmë një jetë dhe standard më të mirë për gjithë ata që



jetojnë në këto hapësira. Të prani-  
shmëve iu drejtua edhe kryetari i  
SHP Gostivar, Nijazi Xhelili, i cili  
shprehi lëvdata për organizatorin